



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr 1129/1 Prot

Tiranë më 08/11/2022

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014, shpall 2(dy) vende vakante për pozicionin e punës Korist Kategoria e Dytë (zë burrash), në Drejtorinë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

- ❖ Korist Kategoria e Dytë - 2(dy) vende (zëra burrash);

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se në datën **06/12/2022 ora 11:00** në **Sallën e Korit të Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë**, në katin e katërt brenda ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor do të zhvillohet audicioni për vendet vakante Korist/e në Sektorin e Korit pranë Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

Të gjithë ata artistë të jashtëm të interesuar për pjesmarrje për këto vende vakante duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP deri me datë 30/11/2022 ora 13:00 dokumentat e nevojshme për regjistrim si më poshtë vijon;

1. Të ketë kryer studimet e larta dega Kanto (bachelor ose mastër);
2. Diplomë e përfundimit të shkollës dhe listë notash të noterizuara;
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
4. CV bashkangjitur me Foto;
5. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e certifikuar, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, eksperiencë pune për pozicionin që konkurojnë, etj); Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter.

Konkurim personal:

- ❖ Shtrirja vokale;
- ❖ Lexim aprima vista i një partiture muzikore ritmik dhe melodik (të dhënë nga komisioni në momentin e konkurimit);
- ❖ Këngë popullore (material i lirë);
- ❖ Këngë qytetare e Shqipërisë së Mesme (konkurenti zgjedh një këngë midis dy alternative të mëposhtme).

1- Një lulishte me trendafila;

2- Me fytyre të qeshur .

- ❖ Këngë qytetare e Shqipërisë së Jugut (konkurenti zgjedh një këngë midis dy alternative të mëposhtme).

1- Hapi sytë e zezë;

2- Çobani.

- ❖ Këngë qytetare e Shqipërisë së veriut (konkurenti zgjedh një këngë midis dy alternative të mëposhtme).

1- S'ka me të bukur se pranvera;

2- O bylbyl o më i bukuri i shpendëve.

- ❖ Romancë lirike nga repertori i përpunuar

1- Asman o Trëndafil i Çeles (Djemtë)

- ❖ Konkurimi bashkë më grupin koral:

Pjesë korale për djem “Bjen lahuta” (përpunim koral nga Pjetër Gaci)

MIRATOI

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigcila VOSHTINA

